

PROF. SOTIR KUNESHKA

(1912 - 1991)

SPAHIU D.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Fizikës.

Kjo mbledhje që organizohet sot për të nderuar Prof. S. Kuneshkën bëhet në kuadrin e kremtimeve të përvjetorit të 50 të fillimit të aktivitetit të Universitetit të Tiranës. Për të kremtuar denjësisht këtë përvjetor të madh në radhë të parë duhet të hedhim vështrimin prapa e në mënyrë të veçantë të nderojmë personalitetet që janë shquar për zhvillimin e universitetit tonë në veçanti dhe të arsimit të lartë në përgjithësi. Ky shërbim miqësor për paraardhësit tanë natyrisht që nuk duhet neglizhuar, sepse nderimi i më të mirëve të së kaluarës duhet të shërbejë si nxitje për ata të sotmit që kanë dëshirën e mirë për të realizuar detyra kurajoze. E një nga këto figura të nderuara të Universitetit tonë është ajo e prof. S. Kuneshkës.

Prof. S. Kuneshka ka lindur më 15 Korrik të vitit 1912 në fshatin Boboshticë të rrethit të Korçës. Ky fshat rreth 7 kilometra larg Korçës, njihet si vendlindja e V. Eftimiut, një personalitet i madh që u bë i famshëm në Rumani. I rritur në një mjedis tepër arsimdashës, siç ishte Boboshtica, ai që i vogël u edukua me dashurinë për shkollën, dijen dhe përparimin. Në kohën kur po rritej Sotiri në Boboshticë nuk kishte burra analfabetë; në këtë fshat kishte dy shkolla fillore, njëra në shqip dhe tjetra në greqisht dhe më vonë, me ndihmën e shoqërisë ‘Vëllazëria Boboshtare’ të Bukureshtit, u hap edhe shkolla e vajzave. Sotiri ndoqi shkollën në gjuhën shqipe dhe me



mbarimin e saj, më 1924 u regjistrua në liceun e Korçës, që njihesh si një ndër shkollat më të mira të asaj kohe në Shqipëri. Në këtë shkollë ai mësoi 9 vjet. Dashuria e veçantë për fshatin e tij dhe dëshira e madhe për të qëndruar pranë

familjes e detyruan nxënësin 12 vjeçar që të bënte më këmbë çdo ditë 14 km rrugë për të vajtur në shkollë, duke u përballë me një vullnet të jashtëzakonshëm sidomos me dimrin e acartë të Korçës, si dhe kur detyrohej të udhëtonte edhe në errësirën e mbrëmjeve apo herët pa zbardhur akoma mirë dita. Nisej nga shtëpia çdo ditë në orën 6 të mëngjesit për të qenë ndër të parët që paraqitej në Lice; po të shohësh regjistrat e kësaj shkolle do të bindesh se ishte ndër nxënësit që kishin bërë më pak mungesa. Kur i dhanë një bursë të vogël për të ndenjtur në konviktin e shkollës ai nuk pranoi sepse, siç thoshte vetë, i pëlqente më tepër jeta e bukur dhe e lirë e fshatit. Një herë e pyeta profesorin si ia bënte për të përgatitur mësimet sepse rruga i merrte shumë kohë e ai mu përgjigj: kur ecja rrugës zgjidhja me mend detyrat që na kishin dhënë mësuesit dhe kur shkoja në shtëpi nuk më mbetej gjë tjetër vetëm sa i shkruaja në fletore. Në këtë mënyrë, ai që fëmijë mësoi të përdorte shumë mirë kohën dhe të mos ta shpërdoronte atë.

Në lice ai u dallua si nxënësi më i mirë i kësaj shkolle deri atëherë, por edhe më pas. Për këtë mjafton t’ju përmendim vetëm këtë fakt: Në një prej pushimeve ndërmjet orëve të mësimit profesori francez i matematikës i jep atij një problem të vështirë për ta zgjidhur, duke i dhënë një afat kohor prej dy ditësh. Por Sotirit i mjaftoi vetëm koha e pushimit për të dhënë një zgjidhje origjinale. Profesori i kënaqur tej mase nga eleganca dhe shpejtësia e zgjidhjes së problemit e fton nxënësin që rrezatonte urtësi dhe inteligjencë dhe e paraqet pranë kolegëve të vet në sallën e mësuesve. *Shikoni - u drejtohet profesori kolegëve të tij – i dhashë këtij nxënësi një problem shumë të vështirë dhe ky e zgjidhi atë në mënyrën më të përsosur dhe në një kohë fare të shkurtër.* Të gjithë e përgëzuan djalosin e talentuar. Në të dyja klasat e bakaloratit, në provime ai ka pas vlerësimin më të mirë që nuk e ka pas asnjë nxënësi tjetër i liceut të Korçës: në provime ai është vlerësuar “shumë mirë”, duke shtuar edhe fjalët: “me përgëzimet e komisionit provues”.

Por ishte një zhgënjim i madh për të, kur me gjithë rezultatet e shkëlqyera të arritura në Lice, nuk iu dha bursa e kërkuar për të vazhduar studimet universitare. I ati i Prof. Sotirit, që ishte akoma mësues, e dinte vlerën e shkollës, e njihte pasionin e të birit për studime të mëtejshme e me gjithë vështirësitë e familjes vendosi ta niste djalin për të studiuar në Paris, në këtë tempull të kulturës botërore. Tregojnë se ai kishte lënë mënjanë 5 napolona flori, për nevoja emergjente ekonomike të familjes, i mori ato dhe i tha të birit: - *Merri bir dhe nisu e mos u bëj merak se do të të dërgoji të tjera, vetëm ti të studiosh e të na nderosh.* Në vitin 1933 erdhi në Boboshticë Profesori i Sorbonës, Andre Masson, një studiues i shquar i gjuhëve të huaja, për tu njohur me një dialekt të sllavishtes që flitej në këtë fshat. Ai kishte bujtur në shtëpinë e Kuneshkës dhe Sotiri e kish ndihmuar si përkthyes. Me ndërhyrjen

e tij dhe të drejtorit francez të Liceut të Korçës ai mundi të marrë një gjysmë burse që qeveria franceze akordonte për njërin nga nxënësit më të mirë të Liceut. Në këtë mënyrë, S. Kuneshka mundi të regjistrohej në Fakultetin e Shkencave të Universitetit të Parisit, një universitet me reputacion të shkëlqyer, dhe ku jepte mësim shkencëtar me famë botërore Pol Lanzaheven. Por jeta në Paris ishte e kushtueshme dhe për të përballuar jetesën iu desh të jepte mësim private për nxënësit e shkollave të mesme që kërkonin konsultime dhe një vit ka dhënë mësim praktike të gramatikës së gjuhës shqipe në shkollën e gjuhëve orientale të Parisit. Duke parë rezultatet shumë të mira të studentit korçar në Paris Ministria e Arsimit të Shqipërisë, në vitin 1935 i akordoi atij një gjysmë burse, duke ia lehtësuar disi vështirësitë ekonomike dhe duke i lënë më shumë kohë të lirë për studime. Në sajë të një këmbëngulje të veçantë, të një shpirti të sakrificës së lartë dhe të etjes së padiskutueshme për dije të plota ai mundi që për 3 vjet të plotësojë me sukses studimet universitare. Në vitin 1936 ai mori “*License d’enseignement*” për Matematikë, Fizikë dhe Kimi të Përgjithshme dhe për Mekanikën Racionale dhe po atë vit u regjistrua për të marrë certifikatën e Mekanikës së Aplikuar dhe pastaj edhe atë të Elektromagnetizmit. Por në vjeshtën e vitit 1937 u thirr me urdhër urgjent të Ministrisë së Arsimit, sepse ishte emëruar profesor i Fizikës dhe Kimisë në Liceun e Korçës. Këtu ai punoi me pasionin karakteristik të tij deri në vitin 1940.

Në gusht të këtij viti ai u detyrua të ndërpriste aktivitetin pedagogjik në Liceun e dashur për arsye se nuk kishte kryer shërbimin ushtarak. E dërguan në Pesaro të Italisë në një shkollë plotësimi për artileri. Atë e mbaroi për 6 muaj dhe mori gradën e nëntogerit e më pas të togerit, por nuk e lejuan të kthehej në atdhe, me gjithë kërkesat e tij të vazhdueshme që kishte bërë. Periudha 4 vjeçare e qëndrimit në shërbimin ushtarak në Itali ishte për të një periudhë vuajtjesh shumë të rënda shpirtërore, duke qenë krejtësisht i izoluar dhe pa pasur asnjë lajm se çfarë po ndodhte në Shqipëri. Letrat e rralla që merrte nga shtëpia ishin gjithnjë të censuruara. Në fillim të vitit 1944 ka braktisur shërbimin ushtarak dhe është kthyer në Bari për të gjetur mundësinë e kthimit në atdhe. Për të përballuar nevojat e jetesës u detyrua të jepte mësim private e kjo vazhdoi deri në tetor kur një mision ushtarak shqiptar e mori me vete dhe e solli në Shqipëri.

Me çlirimin e vendit dhe me rihapjen e Liceut të Korçës, Prof. S. Kuneshka mori detyrën e nëndrejtorit të kësaj shkolle, por nuk qëndroi gjatë në këtë detyrë sepse në shkurt të vitit 1945 u thirr në Ministrinë e Arsimit për të drejtuar sektorin e shkollave. Këtu ai u ndesh me detyra shumë të vështira për ringritjen e sistemit arsimor të Shqipërisë, për të realizuar reformën rrënjësore që duhej bërë në arsim në kushtet e shkatërrimit të përgjithshëm që kishte

shkaktuar lufta. Për të përballuar me sukses këto detyra S. Kuneshkës iu desh të bënte një punë të jashtëzakonshme, një punë vetëmohuese. Në zyrën e tij punohej deri në orët e vona të natës, për të përgatitur planet dhe programet e reja mësimore të shkollave tona, për të evidentuar dëmtimet dhe shkatërrimet e shkollave që kishte shkaktuar lufta, planifikimin e rindërtimit të tyre dhe hapjen e shkollave të reja, si dhe për t’i paraqitur qeverisë nevojat e shkollave për bazën materiale dhe për kuadrin e nevojshëm dhe kualifikimin e tij.

Zhvillimet e vullshme që diktonte koha kërkonin jo vetëm shtrirjen në masë të arsimit parauniversitar, por edhe përgatitjen e kadrove që do të përballonin jo vetëm nevojat e arsimit por edhe të ekonomisë dhe të kulturës. Ky ishte një front tjetër mjaft i vështirë në të cilin Prof. S. Kuneshka me entuziazmin karakteristik të tij filloi të jepte kontributin e vet shumë të vlefshëm. Kur u shtrua detyra e ngritjes së Institutit të lartë Pedagogjik dy-vjeçar, Prof. S. Kuneshka ishte anëtar i komisionit organizativ, që do të përgatiste të gjithë strukturën e këtij Instituti, siç ishin planet dhe programet mësimore.

Hapja e Institutit Pedagogjik dy-vjeçar shënon fillimin e ngritjes së sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe shumë shpejt ai ftohet që të japë aty mësim si pedagog i Fizikës. Pas 3 viteve të një pune të lodhshme, por shumë të dobishme, që kreu në drejtorinë e shkollave të Ministrisë së Arsimit, në vitin 1948 ai emërohet pedagog në këtë Institut dhe një vit më vonë merr detyrën e drejtorit të tij. Dëshira e madhe e Prof. S. Kuneshkës ishte puna në auditor me studentët dhe këtë nuk mund ta zëvendësonte me asgjë tjetër. Në tetor të vitit 1951 kur u hap Instituti Pedagogjik 4-vjeçar Prof. S. Kuneshka është zv. Drejtor i Institutit dhe këtë detyrë ai e kryen deri në vitin 1957, kur me hapjen e Universitetit të Tiranës ai ngarkohet me detyrën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Natyrore. Një vit më vonë me kërkesën e tij ai lë detyrën e dekanit dhe i përkushtohet tërësisht drejtimit të katedrës së Fizikës, detyrë të cilën ai e kryen deri në vitin 1982. Ai vazhdoi punën e pedagogut të Fizikës deri në moshën 74 vjeçare, kur doli në pension.

Që kur mori drejtimin e katedrës së Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, puna e Prof. S. Kuneshkës u përqendrua tërësisht në përgatitjen sa më cilësore të mësuesve dhe fizikanëve të Shqipërisë. Grumbulloi rreth vetes një grup specialistësh nga më të mirët dhe shumë entuziastë si S. Koja, F. Zela, N. Thomo, K. Qendro, R. Bezhani, P. Skënde e më vonë gjeneratën e re të studentëve më të mirë që mbaruan degën e Fizikës. Duke përfituar edhe nga përvoja e profesorëve rusë që vinin në atë kohë në Fakultetin tonë u arrit që për një kohë të shkurtër Katedra e Fizikës e drejtuar nga Prof. S. Kuneshka të kishte plane dhe programe mësimore mjaft të mira, madje shumë më të mira se sa mund të pritej nga një katedër e re, siç

ishite ajo e jona. Pas kësaj mbetej detyra më e vështirë për tu realizuar: ajo e sigurimit të cilësisë së përgatitjes së mësuesve dhe fizikanëve të Shqipërisë. Dhe kjo mund të kryhej duke u dhënë studentëve tekste të mira mësimore si dhe duke u siguruar atyre laboratorë sa më të pasur. Në këtë mënyrë, Prof. Kuneshka zhvilloi një punë shumë të mirë dhe të kujdesme, duke hartuar një tekst voluminoz të kursit të Fizikës së Përgjithshme që përdorën studentët dhe mësuesit e fizikës. Gjithashtu, ai është autor i një sërë tekstesh të tjera të fushave të ndryshme të fizikës me të cilët janë përgatitur studentët tanë dhe ata të Universitetit të Prishtinës, ku Prof. S. Kuneshka ka qenë ftuar për të mbajtur leksione.

Një shqetësim të vazhdueshëm kishte Prof. S. Kuneshka për ngritjen e laboratorëve mësimore për studentët, duke i konsideruar ato si mjetin më të mirë që u jep atyre mundësinë për të njohur konkretisht thelbin e dukurive fizike, pra si të thuash “për të prekur me dorë” cilësitë thelbësore të këtyre dukurive. Madje po të shikojmë karakteristikat e punës së Prof. Kuneshkës që përgatiteshin herë pas here në ato kohëra, theksohet vazhdimisht shqetësimi i tij për të ngritur dhe pasuruar laboratorët mësimorë. Meqenëse mundësitë financiare për të siguruar laboratorë të plotë ishin shumë të kufizuara për arsye të kushteve të vështira ekonomike që kalonte vendi, e vetmja alternativë e ngritjes së këtyre laboratorëve mbetej përgatitja e tyre me forcat dhe mundësitë tona. Kjo nevojë u bë më e mprehtë kur u hap dega 5-vjeçare e Fizikës, nismëtari dhe organizatori entuziast i së cilës ka qenë Prof. S. Kuneshka. Kjo degë do të përgatiste specialistë të fizikës që duheshin për të punuar në fusha të ndryshme të ekonomisë shqiptare, siç ishte ajo e kërkimit të naftës dhe mineraleve, në laboratorët e mjekësisë apo të studimit të ndotjeve të mjedisit etj. Në këtë mënyrë, e gjithë Katedra me Prof. S. Kuneshkën në krye u mobilizua për të ngritur laboratorë të përshtatshëm sipas tematikave të programeve mësimore që kishim. Më kujtohet ajo punë shumë e vështirë që bëme sidomos për ngritjen e laboratorëve specialë, ku studentët do të punonin deri në 6 orë në një ditë të javës, dhe në fakt këto punë laboratorike përmbanin elementët e një kërkimi të vogël shkencor. Mua më takoi të ngrija laboratorin e Elektronikës, së bashku me S. Danin dhe Prof. S. Kojën, kurse Prof. S. Kuneshka me një grup tjetër kolegësh, si P. Pilika, K. Qendro, N. Thomo do të ngrinin pjesën e dytë të këtij laboratorit special. Pasi hartuam tematikën e punëve të laboratorit dhe morëm pëlqimin filluam ndërtimin e laboratorëve. Blemë vetëm aparatet matëse (ampermetra, voltmetra, oshilografë), por të gjitha skemat me të cilat do të punonin studentët i projektua dhe i përgatitëm vetë, ku laborantët tanë, L. Zoto, N. Laço, M. Pançi, B. Latifi. S. Cara, S. Reçi bënë një punë shumë të lavdërueshme dhe të përkushtuar. Besoj se studentët e atëhershëm që janë tani në këtë sallë i mbajnë mend mirë panelet prej bakeliti,

ndoshta jo shumë të bukura, por shumë funksionale, me të cilat ata kryenin punët laboratorike. Hartuam edhe Manualin përkatës që do të përdornin studentët për të kryer punët laboratorike. Këto laboratorë u përdorën për një kohë të gjatë, për më shumë se 20 vjet. Por profesorin gjithnjë e hante merakun në se ato ishin përgatitur në mënyrë cilësore. Rreth 10 vjet më vonë pasi ishin përgatitur laboratorët tona më ra në dorë një Manual i ngjashëm me punët laboratorike të elektronikës botuar nga katedra e Fizikës në Universitetin e Kievit, një nga universitetet më të mira të ish Bashkimit Sovjetik. U gëzova shumë kur konstatova se laboratorin ynë kishte pothuajse të njëjtën tematikë dhe të njëjtën mënyrë trajtimi si ai i Universitetit të Kievit dhe menjëherë ia tregova Prof. S. Kuneshkës, i cili, gjithashtu, u gëzua pa masë sepse u bind se puna jonë kishte qenë, gjithashtu, shumë e mirë. Te puna e tij e devotshme dhe plotësisht e motivuar për hartimin e planeve dhe programeve mësimore, te përpjekjet e vazhdueshme të tij për rritjen cilësore të procesit të mësimdhënies në shkollat tona të larta si dhe në hedhjen e shtatit të brishtë të fizikës shqiptare, sidomos me hapjen e degës 5-vjeçare të fizikës në universitetin tonë gjejmë gjurmët e pashlyeshme të përpjekjeve dhe të sakrificave, të aktivitetit të frytshëm të Prof. S. Kuneshkës. Prandaj me të drejtë ai konsiderohet si pionieri i arsimit të lartë në vendin tonë në fushën e fizikës.

I pasionuar pas aktivitetit të mësimdhënies në auditor ai nuk harroi për asnjë çast ngritjen e tij profesionale, kualifikimin e tij të vazhdueshëm, por edhe punën shkencore. Kur mori drejtimin e katedrës së Fizikës i vuri vetes si detyrë parësore punës për kualifikimin e tij shkencor, megjithëse i kishte kaluar të 45 vjetët. Me një vullnet të fortë dhe disiplinë të rreptë filloi studimet në fushën e radioaktivitetit, ndoshta për arsye se kjo fushë ishte lëvruar në nivel botëror nga shkencorët francezë, ku punimet e M. Kyrisë ishin brilante dhe tejet mbresëlënëse dhe me këto punime ai ishte njohur mjaft mirë kur studioje në Paris 20 vjet më parë. Për të qenë më i sigurtë për nivelin e këtyre studimeve që donte të realizonte, ai u njoh me përvojën e studiuesve rumunë, kur iu dha mundësia të bënte një specializim të shkurtër në Universitetin e Bukureshtit. Gjithashtu, ai bashkëpunoi edhe me specialistët rusë që vinin në atë kohë në fakultetin tonë. Për një kohë shumë të shkurtër ai arriti të përgatisë një studim origjinal që e paraqiti si temë disertacioni në Universitetin Lomonosov të Moskës. Studimi i tij u prit shumë mirë dhe udhëheqësi i temës i entuziazmuar u shpreh se Prof. S. Kuneshkës me meritë mund t'i besohej drejtimi i katedrës së fizikës së përgjithshme në Universitetin Lomonosov. Ky studim u bë objekt i punës së tij shkencore të mëvonshme. Me gjithë mundësitë e vogla që ofronte koha, ai bëri përpjekje të mëdha për të organizuar elementët e parë të punës kërkimore në katedrën e fizikës që ai drejtonte. Në këtë mënyrë, filloi punën grupi i parë i fizikës në vendin tonë që

u angazhua në veprimtari shkencore të pavarur duke studiuar radioaktivitetin e ujërave sipërfaqësore, të mineraleve dhe më vonë edhe të mjedisit rrethues. Ai ishte shumë entuziast dhe përkrahu fuqimisht idenë e ngritjes së Institutit të Fizikës Bërthamore, që është i pari institucion shkencor i fizikës në vendin tonë. Ai së bashku me organet tjera përgjegjëse përzgjodhi dhe propozoi grupin e fizikanëve që do të specializoheshin për të punuar në këtë Institut. Një gëzim i veçantë për Prof. S. Kuneshkën, që aspironte futjen e teknikave të reja në kërkimin shkencor në fushën e fizikës, ishte ngritja e qendrës së Mikroskopisë Elektronike. Jo pak shqetësime pati Prof. S. Kuneshka për të bindur të tjerët që kjo qendër të ngrihej pikërisht pranë katedrës që ai drejtonte, sepse aty e kishte vendin dhe aty mund të realizoheshin studime cilësore, siç u kryen në të vërtetë.

Duke e përmbledhur shumë shkurt aktivitetin e Prof. S. Kuneshkës mjafton të themi se:

Teksti i parë i fizikës universitare në vendin tonë mban emrin e Prof. S. Kuneshkës, artikulli i parë shkencor në fushën e Fizikës ka si autor Prof. S. Kuneshkën, titujt e parë të Docentit, të Profesorit të Fizikës dhe të Akademikut tek ne i janë dhënë atij. Duke mos qenë anëtar i asnjë forumi politik, vlera e këtyre titujve si dhe e dekorimeve: Medalje Pune, Urdhër Pune i kl. II, Mësues i Merituar, Urdhri Naim Frashëri i kl. I, Mësues i Popullit, merr kuptim të plotë dhe sintetizojnë punën vetëmohuese, djersën dhe sakrificat e tij, pasionin e madh dhe motivimin e jetës së tij.

Prof. S. Kuneshka dallohej për modestinë e tij të spikatur dhe figura e tij shërben si një shembull shumë i mirë i një njeriu që punoi me pasion dhe vullnet rinor, gjithmonë korrekt dhe shumë i ndërgjegjshëm për të kryer me saktësinë maksimale punët që merrte përsipër. Në punën e tij ai ka demonstruar vetitë më humane: ndershmërinë, idealizmin, mençurinë, përkushtimin, dashurinë për vendlindjen. Njëherazi, ai ishte shumë i dashur dhe i sjellshëm me të gjithë kolegët dhe studentët e tij, të cilët vazhdimisht e nderonin dhe ruajnë për të një respekt të thellë dhe plotësisht të merituar. Megjithëse në vështrim të parë dukej i sertë, në fakt kishte një zemër shumë të butë dhe të ndjeshme. Me atë buzëqeshjen e tij të ëmbël dhe të lehtë, që rrezatonte mirësi të thellë, ai u drejtohej studentëve dhe bashkëpunëtorëve të tij të rinj me fjalët më të ëmbla dhe fisnike ‘biri im’ ose ‘bija ime’. Ishin fjalë të zemrës së tij që shprehnin një dashuri prindërore dhe që dëshmonin më saktë se çdo gjë tjetër karakterin e tij tepër human dhe dashamirës. I tillë ishte Prof. S. Kuneshka deri sa mbylli sytë përgjithmonë, duke mbetur, kështu, shumë i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë ata që e njohën dhe punuan me të.

Kur po lexoja një autobiografi të Prof. Kuneshkës, shkruar 58 vjet më parë më bëri shumë përshtypje ajo që mund të konsiderohet si kredoja e jetës së tij, e cila është mbajtur qysh kur ai ishte fëmijë, dhe e realizuar me saktësi gjatë gjithë jetës së tij. Më lejoni të jua paraqes ashtu siç e ka shkruajtur ai vetë: ‘*Që kur isha i vogël, prindërit e mi janë munduar të më japin një edukatë siç mund të jepnin dy fshatarë me një farë kulture: të dua dhe të respektoj të afërmit, të jem i drejtë, i ndershëm dhe punëtor. Janë munduar të rrënjosin në shpirtin tim faktin se puna e lartëson njeriun kur kjo bëhet me ndërgjegje, me nder dhe jo në dëm të tjetrit. Pastaj ata më kanë ngjallur dëshirën për studimin*’.

Kjo kredo e jetës së tij shërbeu si baza e pandryshuar e gjithë veprimtarisë së tij, e moralit të tij të lartë. Duke vlerësuar sot aktivitetin e Prof. S. Kuneshkës, si një aktivitet shumë të suksesshëm duhet të themi se në bazën e këtyre sukseseve qëndron motivimi i saktë i jetës së tij. Ai, ashtu si dhe kolegët e tij të nderuar: K. Popa, K. Paparisto, L. Zeko, M. Karajani, P. Pilika S. Koja e plot të tjerë që janë nderi i Fakultetit tonë dhe i Universitetit të Tiranës, punoi për një sistem arsimor universitar të pastër dhe modern, ku cilësia është gjëja për të cilën duhet treguar kujdesi më i lartë dhe ku nuk mund të tolerohet asnjë lloj degradimi. Ky fakt, aq më tepër sot, i duhet kujtuar bashkësisht së punonjësve të arsimit të lartë, asistentëve, pedagogëve dhe profesorëve, sepse gjithmonë ndihet nevoja për shembuj pozitivë dhe të ndritur, që duhen ndjekur, në mënyrë që veprimet degraduese në arsimin e lartë të mos ndodhin kurrësesi. Veprimet e dobëta të ndonjërit që bëhen për përfitime personale dhe që dëmtojnë parimet fisnike të arsimit të lartë bien ndesh me moralin e këtyre figurave të ndritura, të profesorëve të nderuar që ka pasur dhe ka Fakulteti ynë, por edhe Universiteti i Tiranës.

Unë e ndjeva veten të privilegjuar sot që më është dhënë rasti të paraqes para jush aktivitetin dhe jetën e Prof. Kuneshkës, i cili ka qenë jo vetëm mësuesi im i fizikës, por unë kam pasur edhe fatin duke qenë një ndër bashkëpunëtorët e tij më të afërt për 14 vjet me radhë. Prof. S. Kuneshka nderohet nga mijëra mësues dhe specialistë të fizikës që kanë qenë studentët e tij, sepse jetën tonë na e ka pasuruar me forcën dhe qëllimin e jetës së tij, me dashamirësinë dhe ngrohtësinë e shpirtit të tij bujar.